

"ARKEV" SH.P.K.

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
SHOQERIA "ARKEV" SH.P.K.  
BULQIZE

## PROJEKT

**PËR ZHVILLIMIN E VEPRIMTARISË  
MINERARE TË KERKIM ZBULIMIT,  
MINERALI KROM, ZONA MINERARE Nr.532,  
OBJEKTI "FUSHE KISHE",  
BASHKIA BULQIZE, QARKU DIBER**

AUTORE:

STUDIO PROJEKT "TONI"

Inxh. Gjeolog: Dr. Sali Bushi

Inxh. Miniere: Hashim Deva.

Marshajder: Agim Ajazi

ADMINISTRATOR :

Rasim Çupi

TETOR 2018

"ARKEV" SH.P.K.

**Permbajtja e Projekti i zhvillimit te veprimtarise minerare te kerkim-zbulimit per zonen minerare Nr 532, "Fushe Kishe", BULQIZE,**

**A. Pjesa narrative**

**1. Konsiderata të përgjithshme**

- a) Të dhëna mbi subjektin, që ka aplikuar për marjen e Lejes minerare te kerkim-zbulimit per zonen minerare Nr 532, "Fushe Kishe".  
fq. 4
- b) Përshkrim i kapaciteteve tenike dhe profesionale dhe menaxheriale të kërkuesit  
fq. 4

**2. Baza ligjore mbi të cilën subjekti kërkon të hartohet projekti.**

fq.5

- a. Niveli i parashikuar i investimit për lejen minerare.  
fq .6
- b. Tabela e koordinatave të sheshit të kërkuar për leje minerare kerkim-zbulimi  
fq.8
- c. Pasqyrim i dokumentacionit qe vërteton burimin e te dhënavë gjeologjike te përdorura për realizimin e projektit te veprimtarisë minerare te kerkim-zbulimit.  
fq.9
- d. Përcaktimi i vlerës te garancisë financiare për realizimin e programit minimal te punës për fazën e kërkimit.  
fq.9

**3. Pershkrimi i shkurter gjografiko-ekonomik, vendodhja administrative dhe topogarafike e objektit** fq. 10

- a. Gjeografia e zonës, Relievi, klima, bimësia,.  
fq. 10
- b. Hidrografia, hidrogjeologja.  
fq. 10
- c. Demografia, infrastruktura ekzistuese, etj.  
fq. 11
- d. Ekonomia e zonës dhe aktivitetet kryesore  
fq. 11

**4. Përshkrim i shkurtër i ndërtimit gjeolog-tektonik, mineralet e dobishme**

**"ARKEV" SH.P.K.**

**të zonës së kërkuar, vendburimet dhe objektet e njohura.**

fq.11

a. Llojet, stratigrafia e mosha e shkëmbinjve që marrin pjese në ndërtimin e rajonit.

fq.11

b. Zhvillimi i tektonikave kryesore

fq.13

c. Të dhëna të shkurtra mbi mineralet që ndodhen në rajon, shoqëruar me hartën gjeologjike

të saj në shkallë 1:25000, historiku i studimeve dhe punimeve të kryera, rezultatet e tyre. fq13

c. Mineralet e dobishme të zonës nga të dhënat arkivore

fq.13

d. Vendburimet dhe objektet e njohura.

fq.14

e. Vendburimet e shfrytëzuara apo në shfrytëzim.

fq.14

f. Rezervat e njohura sipas vendburimeve dhe objekteve, sasia dhe cilësia e tyre

fq.14

g. Te dhëna mbi mineralizimin.

fq.14

i. Të dhëna mbi morfologjinë dhe teksturën e trupave xeheror.

fq.15

**5. Mënyra e propozuar e kërkim-zbulimit të mineraleve.**

fq.16

**6. Përshkrim i programit të kërkim-zbulimit të propozuar.**

Fq.17

a. Punimet dhe studimet gjeologjike propozuar te kryhen në zonën e kërkuar për leje kërkim-zbulimi,

fq.17

b. Studime hidrogeologjike.

fq.18

c. Studime teknologjike.

fq.18

d. Vlerësimi dhe rivlerësimi i rezervave minerale.

fq.18

**"ARKEV" SH.P.K.**

e. Fazat e kryerjes se tyre sipas afateve (punime kërkimi, punime zbulimi) sipas llojeve te tyre)

fq.18

f. Projektet teknike për secilin nga sheshet, vendburime apo objekte.

fq.18

g. Projektet teknike hartohen në perrputhje me fazat e zhvillimit të programit të punës. fq.19

i. Argumentimi i punimeve që projektohen.

fq.19

ii. Lloji dhe vellimi i punimeve që projektohen.

fq.19

iii. Kosto e tyre.

fq.19

j. Rezervat e zbuluara dhe ato të pritshme.

fq.20

**7. Përshkrim i infrastrukturës së nevojshme për realizimin e projektit**

**të zhvillimit të veprimtarive minerare.**

fq.22

**8. Programi minimal i punës të kërkim-zbulimit të propozuar (Faza e kërkimit).** fq.23

**9. Të dhëna lidhur me punësimin dhe specializim e shtetasve shqiptar**

fq.24

**10. Të dhëna mbi identifikimin e ndikimeve në mjedis gjatë hapjes së punimeve minerare**

fq.25

**11. Përfundime dhe rekondime.**

fq.28

**12. Literatura.**

fq.28

**B. Pjesa tabelore.**

fq.29

1. Tabela përbledhëse e investimeve dhe grafiku i kryerjes për dy vitet e para të lejes. fq.29

2. Tabela e detajuar për zërat e investimeve për vitin e pare.  
fq.30

3. Tabela e detajuar për zërat e investimeve për vitin e dyte.  
fq.31

**"ARKEV" SH.P.K.**

4.Të dhëna lidhur me punesimin dhe specializimin e shtetasve shqiptare.  
fq.32

**C. Pjesa grafike** fq.33

### **ANEKS Nr.1.**

**FORMA DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTIT TË ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARISË MINERARE PER KËRKESAT PËR LEJE MINERARE TË KERKIM ZBULIMIT PËR GRUPIN E MINERALEVE METALORE JOMETALORË, QYMYRET DHE BITUMET, MINERALI KROM, OBJEKTI "FUSHE KISHE".**

Projekti i zhvillimit të veprimtarisë minerare të Kërkim-Zbulimit objekti "Fushe Kishe" zona minerare **Nr.532**, publikuar në planin vjetor 2012, publikuar nga M.E.I. date 04.05.2018, ku pas procedurave konkurese është shpallur fituese shoqëria "ARKEV"sh.p.k..shkresa nr.8240/4 prot., date 23/08/2018 "*Njoftim Fituesi*".

**A. PJESA NARRATIVE** e projektit të zhvillimit të veprimtarisë minerare të kërkim-zbulimit për kërkeshat për leje minerare të kërkim-zbulimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet do të trajtohet si me mëposhte.

### **1. KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME**

a) Të dhëna mbi subjektin që ka aplikuar për marrje leje minerare:

- i) Emri i subjektit sipas regjistrimit në QKB: "ARKEV" sh.p.k..
- ii) Zona minerare me **numër identifikues 532**, "Fushe Kishe", **Bashkia Bulqize, Qarku Dibër**, për të cilën kërkohet leja minerare e kërkim-zbulimit përfshihet në planin vjetor minerar të miratuar te **viti 2012**.

**"ARKEV" SH.P.K.**

- iii) Lloji i mineralit për të cilin kërkohet dhënia e lejes: **Mineral Kromi**
  - iv) Emri dhe mbiemri i administratorit të subjektit aplikues për leje minerare sipas regjistrimit në QKB: **Rasim Çupi**.
  - v) Adresa e selisë së subjektit sipas regjistrimit në QKB: **Lagjia "Gjeologu", Rr "Gjeologu i pare" objekt privat me numur pasurie 2/207 Bulqize.**
  - vi) Nr. i telefonit: **Cel. 068 63 80 001**
  - vii) Emërtimi i njësisë vendore ku përfshihet zona e kërkuar: **Bashkia Bulqize**.
  - viii) Emri dhe mbiemri i drejtuesit teknik: Inxh. Perparim Lika
  - ix) Data e përfundimit të licencës profesionale të drejtuesit teknik: Pa afat.
- c) Një përshkrim të kapaciteteve teknike, profesionale dhe menaxheriale të kërkuesit që i vlejnë kërkuesit për realizimin e veprimtarisë së kerkim-zbulimit, duke përfshirë edhe *Curriculum Vitae* të stafit të tij që do të punojë për këtë veprimtari, si dhe përshkrim të eksperiencës së tij të mëparshme në fushën e industrisë minerare, nëse ka.

### **b<sub>1</sub>. Kapacetet teknike**

Shoqëria "ARKEV" shpk, disponon aktualisht mjetet e duhura teknike për aktivitetin e zbulimit te kromit me punime minerare si: Motokompresore, mjete mekanike te gërmimit, transportit, te kontraktuar, etj.

Punimet e kërkimit ne fazën e pare do te drejtohen nga gjeologu Sali Bushi pjesë e grupit te punës qe punon ne këtë shoqëri dhe sipas nevojave mund te aktivizohen edhe specialist te tjera sipas nevojave te kësaj shoqërie.

### **b<sub>2</sub>. Kapacetet profesionale dhe menaxheriale**

Shoqëria "ARKEV" sh.p.k. për drejtimin e punimeve ne veprimtari minerare ka te plotësuar një staf te plote tekniko ekonomik dhe administrativ te kualifikuar me arsim përkatës dhe me përvojë disa vjeçare ne profesionin e tyre.

**"ARKEV" SH.P.K.**

**1. Rasim Çupi** eshte administrator i shoqërisë, me arsim te larte-Juridik.

Ka një përvojë ne punimet minerare si organizator e drejtues ne subjekt minerare te shfrytezimit.

Me këmbënguljen dhe vullnetin e tij ka arritur te njohe mire procesin e nxjerrjes se mineralit duke thelluar njojuritë edhe ne % e mineralit qe nxjerre e tregton.

Ka aftësi te mira ne menaxhimin dhe tregtimin e mineraleteve. Puna e tij këto vitet e fundit ne sektorin e minierave është e suksesshme.

Gjeologu Sali Bushi eshte i diplomuar per inxhinier gjeolog. Qe ne vitin 1963. Ka nje eksperience gati 40 vjeçare ne projektimin dhe zbatimin e punimeve ne fushen e kerkim-zbulimit te mineraleteve e veçanrisht per mineralin e kromit. Ka kryer per disa vite si kryegjeolog i gjeologjise se Bulqizes dhe i ndermarrjes se kromit ne Kraste-Bater. Ka punuar si specialist ne Sherbimin Gjeologjik Shqiptar dhe se fundi eshte pensionist. Si rezultate i ketije kontributi ne fushen e gjeologjise ka fituar graden shkencore-Doktor ne Shkencat e Gjeologjise

**2. BAZA LIGJORE MBI TË CILËN SUBJEKTI KA HARTUAR PROJEKTIN:**

a) Niveli i parashikuar i investimit, sipas kërkesave të përcaktuara për nivelet e investimit për sipërfaqe të zonës së lejuar. Niveli i parashikuar i investimit përputhet me fazat e zhvillimit të programit të punës për projektin konkret:

**a<sub>1</sub>. Niveli i parashikuar i investimit për lejen e kerkim-zbulimit:**

Programimi i objektivave te lejes minerare te kerkim-zbulimit për territorin e kerkuar bazohet ne ligjin minerar dhe aktet nënligjore e përkatësisht:

- VKM nr.364, date 4.5.2011 “Për përcaktimin e kritereve, vlerës minimale te

**"ARKEV" SH.P.K.**

*sipërfaqes te zonës se lejuar minerare, vlerës minimale te investimit dhe te prodhimit për një leje minerare"*

- VKM 440 date 16.6.2011

-Udhëzimi 718 date 3.10.2011

-Urdhrit nr.304, date 13.4.2011 te Ministrit te METE "*Për miratimin e formës dhe përbajtjes te projektit te zhvillimit te veprimtarisë minerare*" i cili për këtë leje minerare do te kaloje nëpërmes dy fazave:

**Faza e parë (viti i parë-viti i dyte)** : Viti 2019 - 2020 është faza e Kërkimit te Zonës Fushe Kishe brenda konturit te lejes ku puna do te përqendrohet për kontrollin e zonave minerale dhe trupave xeheror te kromit te dhënë e vazhdimësinë e tyre. Konkretisht puna do përqendrohet fillimisht ne marshuta redaksionale, rilevim gjeologjik, hapjen e kanaleve e ridokumentimin e tyre, kryerja e punimeve te reja sipërfaqësore, si dhe kryhen punimet e shpimit qe jane projektuar. Krahas tyre do te bëhen vrojtime sipërfaqësore për përmirësimin e hartës ekzistuese gjeologjike te sipërfaqes se lejes me objektet gjeologjik brenda saj. Në zonë nuk jane parashikur punime nentoksore (galeri) per arsyen se nuk e lejon terreni, pasi eshte i sheshte e punimet minerare dalin me gjatesi te madhe, jo rentabel.

**Faza e dytë (viti i trete):** Ne vitin e trete të lejes mbi bazën e te dhënavë qe do te merrengjate dy viteve të para nga punime sipërfaqësore dhe kryerja e shpimeve, për sipërfaqen që do të mbahet, do të bëhet projekt i zbulimit më punimet përkatëse, projekt i cili do të miratohet në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar.

Shoqëria "ARKEV" sh.p.k. do te kryeje verifikimin e rezervave të zbuluara më parë, si dhe do të bëjë zbulimin e rezervave te reja gjeologjike ne kete rajon.

**"ARKEV" SH.P.K.**

Sipas nenit 14, pika 4 e ligjit minerar, zotëruesi i lejes te kërkim-zbulimit është i detyruar te shpenzoje një vlera te caktuar monetare, për çdo kilometër katror te sipërfaqes se përcaktuar ne lejen minerare, ne mënyrë progresive për kryerjen e punimeve, sipas tabelës te përcaktuar ne vendimin Nr.364, date 04.05.2011.

Sipas VKM nr.364, date 04.05.2011 vlera minimale e investimit për çdo km<sup>2</sup> te zonës se lejuar te kërkim, për aktivitetin minerar te kërkimit te mineraleve ne periudhën gjate dy viteve te pare te lejes se kërkim-zbulimit është 20000 euro/km<sup>2</sup>.

Për rastin tone Sipërfaqja totale e kërkimit ne vitin e pare e te dyte është 1.263 km<sup>2</sup> pra vlera minimale e investimit për këtë zone do te jete jo me pak se:

$$1.263 \text{ km}^2 \times 20\,000 \text{ Euro} = 25\,260 \text{ Euro ose } 3\,283\,800 \text{ leke.}$$

Ne vitin e trete te aktivitetit, faza e zbulimit, do te kryhen investime në bazë të rezultateve të marra gjatë dy viteve të para, për sipërfaqen që do të mbahet gjatë këtij viti (300000 Euro/km<sup>2</sup>).

Shoqëria "ARKEV" sh.p.k. ka fituar te drejtën e aplikimit për leje kërkim zbulimi ne zonën **nr.532** (Shkresa e MIE nr.8240/4 prot., date 23/08/2018 "Njoftim Fituesi"). me këto kritere:

Vlera Totale e investimeve e fituar në konkurim ne zonën minerare **nr.532** Vlera totale e investimit eshte 4 610 000 lekë, ndërsa vlera e investimit për punime gjeologjike është 65.0 % ose 2 996 500 leke.

Subjekti në projektin e hartuar për kërkim-zbulimin për dy vitet e para të lejes ka planifikuar të investoje shumën **6 257 000** lekë, nga të cilat 4 950 000 lekë investime për punime gjeologjike.

Investimet për punime gjeologjike të shprehur në lekë do të janë 79 % e investimit total, ose  $6\,257\,000 \text{ lekë} \times 0.79 = \mathbf{4\,950\,000}$  lekë.

Nga **4 610 000** lekë investime të fituar në konkurim për të investuar për aktivitetin e kërkim-zbulimit, subjekti

***Tabela e investimit total i ndarë në vite në 000/lekë***

Emërtimi	Totali në	Faza e I - rë	Faza e II-
----------	-----------	---------------	------------

**"ARKEV" SH.P.K.**

	000/leke			të Viti i III 000/leke
		Viti i I 000/leke	Viti i II 000/leke	
Vlera e investimit të punime gjeologjike	<b>4950</b>	3115	1835	0
Makineri-pajisje, ngritje kantieri, orendi, etj	<b>1087.812</b>	1087.812	-	0
Mbyllja e aktivitetit, menaxhim mbetjeve .	<b>219.188</b>	109.594	109.594	0
<b>Shuma e investimit</b>	<b>6 257</b>	<b>4312.406</b>	<b>1944.594</b>	<b>0</b>

**b. Formati përshkrues i zonës minerare që kërcohët për leje kërkim zbulimi sipas përcaktiveve të akteve nënligjore të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë";**

Zona për te cilën kërcohët Leja e kërkim zbulimit është zona pranë vendburimit Ternove dhe objekteve te kromit Vetetima, Prroi i Pervallit, Livadhi i Dashit etj, rrëth 2 km nga Ternova, 3 km nga fshati Lene e rrëth 3-4 km nga Thekna.

Ne këtë zone janë zbuluar dhe shfrytëzuar disa trupa xehoror kromi ne me objektet e permendura me lart, me përmasa linzore e përbajtje te ndryshme. Ne këtë objekt gjate aktivitetit te kësaj leje puna do te përqendrohet ne ndjekjen e mineralizimit te njojur ne shtrirje, por dhe ne renie per te shtuar e ngritur ne kategori rezervat. Por ne proces do te vazhdoje puna kerkimin-vleresimin e mineralizimit te kromit ne gjithë sipërfaqen e zonës minerare nr.532.

**b1.Tabela e koordinatave te sheshit te kërkuar për leje minerare zbulimi**

Sipërfaqja e zonës se kërkuar për **Leje Minerare Kërkim-Zbulimi, është 1.263 km<sup>2</sup>,**

Zona për te cilën kërcohët leja e kërkim-zbulimit për mineralin e kromit ndodhet ne rajonin e Prroit te Nenes (Fushe Kishe). Ndodhet ne harten e shkalles 1:25 000 me nomenklature K-34-89-D-c dhe kufizohet sipas koordinatave te mëposhtme

Nr/pike	Y	X
1	44 41	45 86
	582	489

**"ARKEV" SH.P.K.**

<b>2</b>	<b>44 41</b>	<b>45 86</b>
	<b>808</b>	<b>972</b>
<b>3</b>	<b>44 42</b>	<b>45 86</b>
	<b>226</b>	<b>972</b>
<b>4</b>	<b>44 42</b>	<b>45 87</b>
	<b>226</b>	<b>835</b>
<b>5</b>	<b>44 43</b>	<b>45 87</b>
	<b>385</b>	<b>000</b>
<b>6</b>	<b>44 43</b>	<b>45 86</b>
	<b>000</b>	<b>457</b>

Siperfaqja e kërkuar **1.263 km<sup>2</sup>**.

**Zona minerare Nr. 532, Fushe Kishe** e shpallur në planin vjetor minerar të vitit 2012, të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Ifrakstruktura, dhe Energjise, me nr 8240/4 prot, date 23.08.2018 ka leto te dhëna:

**Të dhëna të përgjithshme për zonën konkurruese nr. 532**

Emri i objekt it miner ar	Lloji i Mineral it	Lloji i veprimtari së minerare kërkim- zbulim	Sipërfaqj a e zonës km <sup>2</sup>	Pik a	Y	X
Fushe Kishe, Qarku Diber	Krom	Kërkim- Zbulimi	1.263	1	44 41 582	45 86 489
				2	44 41 808	45 86 972
				3	44 42 226	45 86 972
				4	44 42 226	45 87 835
				5	44 43 385	45 87 000
				6	44 43 000	45 86 457

**"ARKEV" SH.P.K.**

Sqarojmë se zona e kerkuar nuk bie ne zone te mbrojtura dhe nuk ka mbivendosje me zona te tjera te licencuara apo te planifikuara.

**c) Pasqyrimi i dokumentacionit që vërteton burimin e të dhënave gjeologo-minerare të përdorura për realizimin e projektit të veprimtarisë minerare të zbulimit.**

Projekti është hartuar nga stafi teknik i shoqerise ne baze te kërkesës se bërë nga subjekti "Arkev" shpk për rajonin e Fushe Kishes. Subjekti "Arkev" shpk ne marreveshje me subjektin "Çimi Kraste"shpk ka hartuar projektin në bazë materialit gjeologjik arkivor (dokumentacion i cili është blere nga subjekti "Çimi Kraste"shpk sipas tarifave përkatëse ne fuqi).

**d. Përcaktimi i vlerës së garancisë financiare për realizimin e programit minimal te punës.**

Vlera e garancisë financiare ne zbatim te Udhezimit të Ministrit Nr. 718, datë 03.10.2011 "Për menyeren e vleresimit të garancive financiare të lejeve minerare", për vitin e pare e te dyte për investimet e parashikuara për tu kryer ne zonen minerare janë si në tabelën e mëposhtme:

**Vlerësimi i garancisë financiare për realizimin e programit minimal te lejes kërkim-zbulimit:**

Sipërfaqja e zonës se lejuar km <sup>2</sup>	Grupi mineraleve	Vlera minimale e investimit e vlera minimale e garancisë për programin minimal te punës lejes kërkim-zbulimit		Vlera minimale totale e garancisë financiare për realizimin e programit minimal te punës	Vlera minimale e programit minimal te punës për vitin e pare	Vlera minimal e e programit minimal te punës për vitin e dyte
		Vlera minimale investimi për programin	Vlera minimale e garancisë financiare për realizimin programit			

**"ARKEV" SH.P.K.**

		minimal te punës €/km <sup>2</sup> sipas VKM nr.364	minimal te punës sipas grupit mineralit €/km <sup>2</sup>			
1.263 km <sup>2</sup>	Metalore	20000	15000	1.263 km <sup>2</sup> x 15000 €/km <sup>2</sup> = 18 945 Euro	15 000 Euro	15 000 Euro

### **3. PËRSHKRIMI I SHKURTËR GJEOGRAFIKO-EKONOMIK, VENDNDODHJA ADMINISTRATIVE DHE TOPOGRAFIKE E OBJEKTIT**

#### **a. Gjeografia e zonës, reliivi, klima, bimësia**

Zona, brenda se ciles, ndodhet objekti i kerkuar per leje minerare te kerkim-zbulimit, administrativisht perfshihet ne territorin e Bashkise Bulqize (Njesia Administrative Martanesh), Qarku i Dibres.

Zona ka forme relativisht te sheshte ne qender, por dhe me forma shpatore e lugina te bute malore, e vendosur rreth +1500 deri +1700 m mbi nivelin e detit.

Siç e theksuam edhe me larte zona eshte e sheshte ne pjesen qendrore ku dhe takohet mineralizimi i kromit, por ne krah kemi shpate me pjerresi mesatare e lugina te cekta malore, pra kemi nje relief relativisht te qete pa zona te thepisura.

Majat me te larta te zones brenda siperfaqes se kerkuar per leje, jane ajo me lartesi (1700 m) dhe ajo me lartesi + 1672m.

Zonen e pershkoni perroi i Nenes (pjesa fundore-fillimi). Ky perrua bashkohet me prroin e Lajthise duke formuar prroin e Mulliasit, qe me ne perendim bashkohen me prrenj te tjere tu derdhur ne lumin e Matit, por ne nje nivel hipsometrik shume me

### **"ARKEV" SH.P.K.**

poshte duke mos patur ndikim negativ gjate zbulimit dhe shfrytezimit, bile eshte pozitive pasi eshte drenuse per ujrat nentokesore te zones.

Zona, ne fjalë, eshte nje zone relativisht e zhveshur, pa qendra banimi ne te, apo prane saj. Po te kemi parasysh kuotat relativisht te larta mbi nivelin e detit, +1500 deri +1700 m, klima eshte kontinentale, me dimer te gjate, te lagesht e te ftohte dhe vere te shkurter, te thate e te nxehete.

Dimri, i cili fillon zakonisht nga 1-15 Nentori dhe mbaron nga fundi i muajit Mars, mesi i muajit Prill, shoqerohet me rreshje te medha debore, qe zakonisht kalojne trashesine 2 (dy) m. Dimri eshte shume i ftohte, me ngrica, erera qe fryjne kryesisht nga veriu dhe verilindja. Temperaturat me te ulta te regjistruara ne kete periudhe jane -20° C. Nga sa me siper, ne periudhen 4.5-5 mujore te dimrit eshte e pamundur te punohet, prandaj ne objekt do te parashikohet te punohet vetem 7 muaj ne vit (Prill-Tetor).

#### **b. Kushtet hidrografike dhe hidrogjeologjike**

Objekti ndodhet ne nje zone te qete, me perroska te vogl dhe vija ujembledhese, te cilat nuk do te ndikojne gjate procesit te punimeve gjeologo-zbuluese. Objekti eshte i pa njojur, mbasi ne afersi nuk ka patur ndonje objekt minerare te shfrytezuar me pare por per faktin se prerja erozionle sidomos ajo jugore, por dhe ajo veriore, ben qe ujrat te drenojne poshte ne drejtim te prroit te Nenes, prandaj mendojme se nuk do te kete problem shqetesuese te ujrave nentokesore, pra mund te themi qe kemi kushte hidrogjeologjike te favoresheme.

#### **c. Demografia , infrastruktura ekzistuese.**

Qendrat me te aferta te banuara jane fshatrat Lene, Ternove e Theken, me nje popllesi rreth 8000 banore. Nga keto zona do te sigurohet fuqia punetore e nevojeshme per zbulimin e objektit. Objekti i kerkuar, duke qene i vendosur ne nje zone malore, ku nuk ka qendra te banuara rreth tij, apo aktivitet tjeter te rendesishem, ka nje infrastrukturre te dobet. Ne zone ka linje elektrike dhe rruge. Ne lindje te zones kalon nje rruge qe shkon per Zerqan e pa mirembajtur, pra kerkon permirsime. Ka rruge qe lidhet me minieren e Theknes.

Nga kjo rruge egziston mundesia e levizjes se makinerive e pajisjeve qe do te perdoren per zhvillimin e aktivitetit te kerkim zbulimit.

**"ARKEV" SH.P.K.**

#### **d. Ekonomia e zones dhe aktivitetet kryesore te saj**

Zona e fshatrave, nga ku do te sigurohet edhe fuqia punetore per shfrytezimin e ketij objekti, eshte nje zone me nivel te ulet ekonomik. Klima e ashper, infrastruktura e dobet rrugore, siperfaqet e kufizuara te tokave bujqesore produktive, largesia nga qendrat e banuara, apo qendra administrative-Bulqize, kane bere qe banoret e kesaj zone te levizin familiarisht drejt qyteteve fushore, kryesisht, Tirane e Durres. Kjo po çon dale dale-ngadale ne çpopullimin e zones.

Nder aktivitetet kryesore te popullsise se kesaj zone, mund te permendim: blegtorine, shfrytezimin pyjor dhe perpunimin e drurit, si dhe aktivitetin minerar.

Nje pjese e mire e banoreve eshte aktivizuar si punetore dhe specialiste ne subjektet private, qe aktualisht, jane te pajisur me leje minerare shfrytezimi ne objektet e kromit si: Ternove, Theken, Kaptine, Perroi i Pervallit, etj.

#### **4. PERSHKRIMI I SHKURTER I NDERTIMIT GJEOLOGO-TEKTONIK PER MINERALET E DOBISHME TE ZONES SE KERKUAR DHE PER VENDBURIMET DHE OBJEKTET E NJOHURA.**

##### **a. Llojet, stratigrafia dhe mosha e shkëmbinjve qe marrin pjese ne ndërtimin e rajonit.**

###### ***Ndertimi gjeologjik i rajonit***

Zona kerkuar ben pjese ne masivin ultrabazik te Bulqizes, po thuaj ne pjesen me jugore te tije. Ky masiv eshte pjese perberese e kompleksit ofiolistik te Albanideve (Brezi lindore). Ka nje siperfaqe prej rreth 350-400 km<sup>2</sup>, gjatesi gati 30 km dhe gjeresi nga 10-15 km.

Ne rajon kemi formime magmatike dhe formime sedimentare Kuaternare (mbulesore).

**-Shkenbinjt Magmatike.** Perfaqesohen nga *harcburgite, dunite, serpentinite, piroksenite, seria damarore dhe mikrogabro*.

**Peridotitet (Harcburgitet)** jane shkëmbinj jo shume te perhapur ne rajon dhe the Jane te tipit lercolistik. Ato zene rreth 10-15 % te siperfaqes se zomes. Ato perhapjen e kane ne pjesin jugelindore te zones, duke dale here pase here ne brendesi te mbuleses kuaternare, gje qe flet se ato kane perhapje me te madhe por Jane te

**"ARKEV" SH.P.K.**

mbuluar nga deluvionet. Peridotitet takohen ne forma breznimesh me permasa te kufizuara edhe brenda duniteve duke qene dhe baza e marrjes se informacionit per elementet shtrushmerise (elementeve strukturore). Piroksenet jane ne per gjithesi kokerr mesem. Jane relativisht me pak te perajruar dhe ne siperfaqe kane pamje puçerrzore per shkak te permbajtjes se kristaleve te piroksenit. Mikroskopivisht perbehent nga kokerriza te olivines dhe pikoksenit rombik, me strukture hipodiomorfe-kokrrizore, me mbivendosje te asaj rrjetore. Ne per gjithesi olivina paraqitet e serpentinizuar, ndersa pirokseni me i fresket.

**Dunitet,** Keto shkembinj kane perhapjen kryesore ne rajon. Kane ngjyre te verdhe ne te gjelbert e here here te erret ne varesi te serpentinizimit, te nderprere nga damare te holle serpentine duke e kthyer teksturen e shkembit nga masive ne ate masive rrjetore.

Alterimi ne dunite eshte pak me i madhe se ne dunite, por nuk i kalon me shume se 4-5 cm, duke u dhene ngjyre kashte te zverdhur.

Jane te serpentinizuar dhe shpeshe te ndotur nga magnetiti dytesore.

Ndersa serpentinizimi konstatohet dhe ne thellesi, ne punimet e shpimit, kryesisht ne zomat tektonike qe ne zone jane relativisht te zhvilluara.

Mikroskopikisht dunitet jane monomineral te perbere nga olivina, e cila formon kristale izometrike dhe ne ndonje rast pake te zgjatur nga kataklazi.

Dunitet permbajne kokrriza kromiti aksesor ne sasi deri ne 2% , por shpesh takohen dhe shlire kromshpindeliti ne perputhje me shtrirjen e perghitheshme VP-JL e me renie kryesisht JP.

Vete zgjatimi i linzave te peridotiteve na jep qarte shtrirjen e ketyre shkembinjeve. Kontaktet dunit-peridotit, ne per gjithesi jane te qarta por verehen dhe raste te kalimeve graduale, te valezuara e te dhembezuara dhe ne ndonje rast tektonik. Kemi raste kur kontakti i tyre eshte i mbuluar nga dpozitimet deluvialo-proluviale.

**Serpentinitet** Kane perhapje jo shume te madhe. Ato takohen kryesisht ne kontaktet e llojeve ultrabajike, gjithashtu takohen dhe ne zonat e fuqishme tektonike. Paraqiten kryesisht me ngjyre te gjelbert te erret, deri ne te zeze. Jane te formuara nga serpentinizimi intensiv i duniteve dhe harzburgiteve, ku me veshtiresi dallohen relikte te mineralizimit primar.

### “ARKEV” SH.P.K.

**Piroksenitet.** Perfaqesojne serine damarore te shkembinjeve ultrabazike te ketij rajoni. Takohen trajte te damareve me gjatesi 20-30 m e trashesi disa cm, me kufij te qarte me shkembinje qe nderpresin. Kristalet e Px kane madhesi qe shkojne deri ne 3-4 cm, duke na dhene nje pamje te tipit pegmatite. Jane te tipit rrjetore, nderpreres te formacioneve baze. Paraqiten me ngjyre te gjelbert, deri ne te gjelbert te erret.

**Mikrogabro.** Jane shkembinje qe perhapen ne rajon ne forme pullash me permase te kufizuara e te rralla ne fushen dunitike. Perberja e tyre eshte pirokseni e plagioklazi. Amfiboli eshte i tipit aktinolit. Jane shkembinj me teksture mikrrokokrrizore e strukture gabroide. Kane ne kafe te erret qe shpesh ne pamjen e jashteme ngatrrohen me kromitet e varfera, por ato kane ngjyren e vijes te bardhe.

**Formacionet Kuaternare.** Perfaqesohen nga formimet deluvialo-eluviale.

**Depozitimet Kuaternare (Deluvio-proluviale)** kane perhapje te gjere ne rajon dhe takohen ne trajte te mbulesash, me konfiguracione te ndryshme, por qe kane perzierje te tyre ne luginat e perrenjeve. Perhapjen me te gjere e kane kryesisht ne pjesen jugoperendimore, jugelindore te rajonit. Ne keto perhapjen me te madhe e kane deluvionet e shpatit e me pake ato proluviale edhe per shkak se zona eshte pak e prekur nga rrjeti hidrik. Deluvionet perfaqesohen kryesisht nga depozitime suargjilore, me permbajtje te madhe te coprave te shkembinjeve ultrabazike. Proluvionet perfaqesohen nga material zallizhtor (poplore) dhe ndershtresa surerash e suargjilash. Shpesh depozitimet deluvialo-proluviale takohen te perziera, sidomos ne fundet e shpateve, ne prrenje e prroskat. verejtur se trashesia e tyre eshte ne perpjithesi e vogel, por ka raste qe ajo arrin deri ne 2-3 ml.

### b-Zhvillimi i tektonikave kryesore

Si ne te gjithe vendburimet dhe objektet e kromit, te zbuluara dhe shfrytezuara ne masivin e Bulqizes, edhe ky objekt nuk mund te mendohet pa pranine e tektonikes shkeputese te pas mineralizimit. Gjate kryerjes se vrojtimeve e rilevimeve eshte konstatuara se tektonika shkeputes eshte relativisht e zhvilluar duke i coptuar trupat me shume ne planin e renies, por dhe te shtrirjes, veçse spostimet jane te vogla, gje qe nuk kane veshtersuar ndjekjen e mineralizimit. Tektonika do te dokumentohet gjate kryrjes se punimeve kerkim zbulimit.

#### **"ARKEV" SH.P.K.**

Tektonikat e fuqishme jane teresisht te millonitizuar, duke krijuar pamje mikroshtresash ne brendesi, teresisht te serpentizuara. Theksojme se brenda tektonikes takohen shlire e masa kromiti me trashesi deri 0.2-0.3 m, e gjatesi deri 2-3 m. Kjo vjen nga perqendrimet qe krijohen gjate levizjeve e coptimeve tektonike, por dhe mund te jene tektonika ngritese qe kane marre copra nga trupa qe mund te ndodhen ne thellesi.

#### **c-Mineralet e dobishme te zones nga te dhenat arkivore pershkrimi me i plete per mineralin apo mineralet per te cilat kerkohet leja.**

Mineralizimi kromitik qe eshte i zbuluar e qe mendohet te zbulohet me tej eshte i tipit magnokromit, i pershtatshem per prodhim ferrokromi karbonik. Cilesia e mineralit ne daljet kromitike eshte e ndryshme dhe rezulton si vijon:

- Trupi nr.1 varjon nga 27.74 % Cr<sub>2</sub>O<sub>3</sub>, (kanali 9) deri ne 39.9 % Cr<sub>2</sub>O<sub>3</sub>, (kanali 5)
- Trupi nr.2 varjon nga 13.11 % Cr<sub>2</sub>O<sub>3</sub>, (kanali 12) deri ne 41.93 % Cr<sub>2</sub>O<sub>3</sub>, (kanali 9)

Mbeshtetur ne analizat kimike te mostrave, perm bajtja e FeO leviz nga 9.86-11.8%; Al<sub>2</sub>O<sub>3</sub> shkon nga 5.62-8%. Raporti krom/hekur shkon nga 2/1 ne 3.5/1.

#### **d-Vendburimet dhe objektet e njohura**

Ne afersi te zones se studimit kemi keto objekte kromi.

- Vendburimi Ternova
- Objekti Pylli i Zi
- Objekti Vetetima
- Objekti Perroi i Pervallit
- Objekti Livadhi i Dashit
- Objekti Kopshti Kalit
- Objekti Kaptina

#### **e-Vendburimet e shfrytezuara apo ne shfrytezim**

### “ARKEV” SH.P.K.

Ne rajonin per rreth objektit te kerkuar ndodhen disa vendburime dhe objekte te mineraleve te dobishme ne shfrytëzim si me poshte:

- Vendburimi i Ternoves, ku ka disa ka leje shfrytezimi dhe aktualisht shfrytezohet.
- Objekti Pylli i Zi, cili ka leje shfrytezimi dhe aktualisht shfrytezohet.
- Objekti Kaptina ku ka disa ka leje shfrytezimi dhe aktualisht shfrytezohet
- Objekti Prroi i Pervallit i cili ka leje shfrytezimi dhe aktualisht shfrytezohet.

#### **f-Rezervat e njohura sipas vendburimeve dhe objekteve.**

Nga vendburimet e objektet e me siperme me i rendesishmi eshte Terrnova si per nga rezervat, por dhe nga cilesia, pastaj vjen Pylli i Zi, Kaptina, Perroi i Pervallit, Kopshti i Kalit, Livadhi i Dashit e Vetetima. Ternova dhe Pylli i Zi kane kryesisht mineralizim te pasur, kurse Kaptina ka rezerva, por cilsia e mineralizimit varjon nga i varfer deri ne mesatare. Objektet e tjera kane mineralizime te varfra dhe rezerva te pakta perveç Prroit te Pervallit qe ka disa dhjetra mijra ton.

#### **g-Te dhëna mbi mineralizimin**

Rajoni ku vendoset objekti i kromit per te cilin kërkohet te zhvillohen punime gjeologo zbuluese eshte i vendosur ne shkëmbinjtë ultarabazike (dunite, dunite te serpenitizuara). Nga studimet e rilevimet e kryera, ne objektet e mineralizuara te zones rezulton se jemi ne pjesen me te siperme te prerjes magmatike, ne sekuencen kumulative.

#### **Ndertimi Gjeologjik i Objektit**

Objekti i kerkuar per leje kerkim – zbulimi Prroi i Nenes-Fushe Kishe siç e kemi theksuar edhe me lart, ndodhet ne pjesen jugore te masivit ultrabajzik te Bulqizes. Punimet gjeologo-kerkuese per rreth keti objekti kane qene te shumta dhe te kryera vite me pare nga ish-Ndermarrja Gjeologjike Bulqize dhe ish-Ndermarrja Gjeofizike Tirane. Ndertimi gjeologjik u pershkrua mbi bazen e verifikimeve e rilevimevet dhe nga karakteristikat e shkembinjve homologe me ato te objekteve te aferta me objektin tone. Nga rilevimet e jryara be shkallen 1:25 000 e 1:10 000 ne zonen e Fushe Kishes takohen: *peridotite (harcburgit-lercolite)*, *dunite*, *serpentinite*, *piroksenite*, trupat e mineralizuar *dhe mbulesa kuaternare*.

### "ARKEV" SH.P.K.

Mineralizimi i kromit ne zonen e kerkuar, eshte evidentuar nga punime siperfaqesore dhe punime shpimi te kryera vite me pare nga ish-Ndermarrja Gjeologjike Bulqize dhe ish-Ndermarrja Gjeofizike Tirane. Mineralizimi perfaquesohet nga dy dalje te mineralizuara te tipi linezoro-thjerrzore, me trashesi mesatare nga 0.6-2 m, me shtrirje gati veriperendim – juglindje (me gjatesi rrethe 120 m me nnderprerje) e me renie te forte jugperendimore (10-15 m) me kend renie 75-80°. Ne daljen kromitike te Perroit te Nenes - Fushe Kishe, mineralizimi ka teksture brezore ne siperfaqe, ku brezat e kromit paraqiten me pikezime te mesme deri te dendura, por takojme mineralizim me teksture me pikzime te rralla deri te mesme.

Theksojme se vihen re raste qe ne pjese te kufizuara mineralizimi ka luhatje te shpejta cilesore nga 40 deri ne 13 % (kanalet 12 dhe 3) te cilat do te verifikohen gjate procesit te kerkim zbulimit.

#### i. Te dhëna mbi morfologjinë dhe teksturën e trupit xehleror.

Trupat e kromitit vendosen ne fusha relativisht te mëdha dunitesh, pra vendosen ne pjesen me te siperme te prerjes magmatike ultrabazike. Jemi ne pjesen kumulative te ultrabazikeve ku ne per gjithesi takohet mineralizim kromi me teksture brezore ne siperfaqe, ku brezat e kromit paraqiten me pikezime te mesme deri te dendura, por takojme mineralizim me teksture me pikzime te rralla deri te mesme.

Mineralizimi perfaquesohet nga dy dalje te mineralizuara te tipi linezoro-thjerrzore, me trashesi mesatare nga 0.6-2 m, por interesant eshte fakti qe megjithese jami ne mjesis dunitik me permasa te konsiderushme, trupat bien me renie te forte, gati vertikale.

#### Punimet e kryera më parë në zonën nr. 532.

Zona minerare nr.532 është e mbuluar me rilevim 1:10 000 të kryer nga Ish. Ndermarrja Gjeofizike Tirane.

Në zonën minerare 532 nga ish/ndërmarrja gjeologjike Bulqize, janë kryer punime gjeologjike si kanale, shpime. Janë kryer një numër i konsiderueshem kanalesh gjatë shtrirjes, të cilët kanë takuar dy trupa xehleror kromitike. Kanalet e kryera nga juglindja drejt veriperendimit janë: K13, K 9, K 12, K 3, K 4, K5, K 6, K 11, K 10. Kanalet kanë takuar trupat xehlerore më trashësi nga 0.2 mderi në 2 ml, me cilesi nga zonë e mineralizuar, deri në 44.84 % Cr<sub>2</sub>O<sub>3</sub> (kanali 5).

**"ARKEV" SH.P.K.**

Në kete zone janë kryer disa shpime në prerjet I, III dhe V, nga të cilat janë marrë rezultate positive, por në prerjet I dhe V janë takuar zona të mineralizuara, ndërsa shpimi 4 në prerjen III ka takuar trup mineral në intervalin 64.4-70.4 (6 ml) me permbytje 18.85 % Cr<sub>2</sub>O<sub>3</sub> në horizontin 1580 m, rrëth 60 m poshtë sipërfaqes.

## **5. Mënyra e propozuar e kërkim-zbulimit te mineraleve**

Fazat e zhvillimit te programit te kërkim-zbulimit:

Në mënyrën e propozuar të kërkim zbulimit, parashikohet realizimin e tij ne dy faza.

- **Faza e parë (viti i parë-viti i dyte)**: Është faza e kërkimit ne te gjithë zonën e Fushe Kishes brenda konturit te lejes, ku puna do te përqendrohet për kontrollin e zonave minerale dhe trupave xeheror te kromit te dhënë e vazhdimesinë e tyre. Do te kryhen fillimisht marshuta redaksionale, rilevim gjeologjik, hapje e kanaleve e dokumentimi i tyre, kryerja e punimeve te reja sipërfaqësore, do kryhen punimet e shpimit te projektuar, si dhe do te merren prova për vlersimin e Cr<sub>2</sub>O<sub>3</sub>.
- **Faza e dytë (viti i trete)**: Ne vitin e trete të lejes mbi bazën e te dhënavë qe do te merren gjate dy viteve të para nga punime sipërfaqësore dhe kryerja e shpimeve, për sipërfaqen që do të mbahet, do të bëhet projekti i zbulimit me punimet përkatëse, projekt i cili do të miratohet në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar. Gjatë kësaj faze do te merren prova për vlersimin e Cr<sub>2</sub>O<sub>3</sub> dhe do te përpilohet raporti përfundimtar i punimeve te kërkim zbulimit për te konkluduar ne se eshte rentabel shnderrimi në leje shfrytëzimi i mineralit qe do te zbulohet ne këtë zone.

Ne zonen e studimit gjatë periudhës së fazës së parë (2 vitet e para të lejes) do te kryhen këto punime:

a. Marshuta redaksionale 1:10000	15 km
b. Rilevim topografik	0.8 km <sup>2</sup>
c. Rilevim gjeologjik ne shkallen 1:2000	0.8 km <sup>2</sup>
d. Punime minerare sipërfaqësore (pastrime, kanale, germime)	1000 m <sup>3</sup>

**"ARKEV" SH.P.K.**

e. Punime minerare nentoksore, puzesa (gjate rilevimit gjeologjik per te rritur informacionen ne zonen e mbuleses deluvinale)

50 ml

f. Punime shpime 325 ml

